



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

### GJYKATA SUPREME/VRHOVNI SUD

---

GJS-2022-020

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Supreme A.M., e duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga Prokurori i Shtetit R.M., dhe sipas detyrës zyrtare, më datë 15.12.2022, merr këtë:

#### A K T V E N D I M

**REFUZOHET**, ankesa disiplinore e Prokurorit të Shtetit R.M., e parashtruar ndaj gjyqtarit të Gjykatës Supreme A.M., **SI E PA BAZUAR**.

#### A r s y e t i m

Si autoritet kompetent, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës Enver Peci, më 20 tetor 2022, përmes Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka pranuar disa email/njoftim, të komunikimit në mes të Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, R.M., dhe Kryesuesit të KGJK A.Z., nga përmbajtja e të cilit prokurori i Shtetit përveç tjerash e njofton Kryesuesin e KGJK, me pretendim se, më 17 tetor 2022, në intervalin kohor 08:00 – 09:00, gjyqtari A.M., ishte takuar me gjyqtarin e procedurës paraprake I.I., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me ç‘rast i njëjti i kishte kërkuar gjyqtarit I., që ta refuzonte kërkesën e prokurorit për sekuestrim të përkohshëm të vilave, sepse nuk ka bazë juridike, me pretendim se gjyqtari M., ka ndërhy në pavarësinë e gjyqtarit në vendimmarrje, e të cilat veprime janë kundër etikës profesionale si dhe dëmtojnë hetimet në këtë rast.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, si autoritet kompetent fillimisht meqenëse prokurori në fjalë në njoftimet e tij mes tjerash, përveç pretendimeve për shkelje të kodit të etikës profesionale ka konsideruar se këto veprime konsumojnë edhe vepër penale, për të cilën thekson se kanë filluar hetim të veçantë për disa zyrtar të gjyqësorit, konsideron se sipas nenit

11 paragrafi 3 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh që në këtë situatë ndërpritet parashkrimi dhe suspendohet procedura disiplinore me qëllim të mos rrezikimit të hetimeve, për këtë arsye nuk ka ndërmarr veprime disiplinore.

Mirëpo, më datë 12.11.2022, prokurori në fjalë ka dal dhe publikisht në emisionin “Betimi për Drejtësi”, e me këtë rast vet i ka zbulua të gjitha këto pretendime, për këtë arsye kryetari si autoritet kompetent, më 16 nëntor 2022, njofton KGJK-në, se ka filluar shqyrtimin e këtyre pretendimeve sa i përket shkeljeve të pretenduara disiplinore.

Pretendimet nga ana e Prokurori të Shtetit R.M., më 12 nëntor 2022, në emisionin e transmetuar në KTV, “Betimi për Drejtësi”, ishin të ngjashme me emalin e komunikimit me kryesuesin e KGJK-së, se gjyqtari M., është takuar me gjyqtarin I., më 17 tetor 2022, në intervalin kohorë prej orës 08:00 – 09:00, në një restorant të pikës së karburanteve “H. P.” në Ferizaj, se i njëjti i ka kërkuar gjyqtarit I., që ta refuzoj kërkesën e prokurorit të shtetit për sekuestrim të përkohshëm të vilave, pasi që nuk ka bazë ligjore.

Me qëllim të vërtetimit bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj, të këtyre pretendimeve e sipas detyrës zyrtare autoriteti kompetent ka kërkuar nga gjyqtari I.I., dhe gjyqtari A.M., të deklarohen lidhur me këtë rast dhe ka pranuar deklaratat e të njëjtëve.

Gjyqtari I.I., sipas kërkesës së kryetarit të Gjykatës Supreme lidhur me pretendimet e prokurorit në deklaratë e 21 nëntor 2022, potencon se:

Gjatë vitit 2021, si gjyqtar i procedurës paraprake ka vendosur kërkesa të prokurorit për caktim të paraburgimit në një çështje të procedurës paraprake ndaj të pandehurit B.N., etj. Edhe gjatë vitit 2022, ka vendosur kërkesat e prokurorit për caktim të paraburgimit dhe të masave të tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë, ndaj të pandehurve të tjerë që dyshoheshin se veprimet e tyre e që janë të ndërlidhura me dyshimet ndaj të pandehurit B.N., por varësisht prej kohës kur janë paraqitur kërkesat e prokurorit në gjykatë, janë formuar 9 (nëntë) lëndë me numra të veçantë, e po ashtu këtë çështje, ka vendosur në një numër të konsiderueshëm të kërkesave të prokurorisë për sekuestrim të përkohshëm dhe masa për sigurimin e pasurisë.

Tutje lidhur me këtë rastin thekson se Prokuroria Themelore në Ferizaj, më 14 tetor 2022, në Gjykatë ka dorëzuar kërkesën për sekuestrim të përkohshëm ku është formuar lënda me shenjë:2022:019820. Po ata ditë rreth orës 11:00, thekson se ka lëshuar objektin e gjykatës, nga se kishte për të marrë terapinë e caktuar mjekësore se gjatë muajit shtator-tetor 2022, ka pasur probleme shëndetësore, komplikime me zemër, një kohë ka qëndruar në pushim mjekësor. Pas vikendit, me fillimin e javës, duke ardhur në vendin e punës, diku rreth orës 08:00 apo 08:30, në Ferizaj, është dëgjuar në telefon me gjyqtarin A.M., për të cilin thekson se shprehu dëshirë që të takohen për ta pyetur për shëndetin, ashtu që është ndalur në një kafiteri afër pompës së derivateve “H.” në Ferizaj, me ç’ rast thekson se janë takuar me kolegun dhe kanë pirë kafe duke shpjeguar me këtë rast se gjatë kësaj kohe, pra me paraqitjen e pengesave në zemër është kontaktuar nga shumë miq, shokë e kolegë për ta pyetur për shëndetin, e kanë vizituar shumë prej tyre në shtëpi, dhe në zyrën ku punon. Për gjyqtarin A., thekson se kanë punuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Departamentin e Krimeve të Rënda prej vitit 2013, deri sa është avancuar gjyqtar në Gjykatën Supreme, i njëjti e ka telefonuar, e ka pyetur për

shëndetin siç ka ndodh edhe më 14 tetor 2022, kur edhe janë takuar, kanë qëndruar rreth 30 minuta, kanë pas biseda normale të përditshme, duke e pyetur për shëndetin, familjen, si kolegë dhe shokë kanë biseduar edhe për punët e përditshme, planet e jetës, etj. Kanë përmendur si temë aktuale dhe aksionin policor të ndërmarr në parkun kombëtar "Sharri", dhe tema të tjera të rëndomta.

Tutje shton se nuk kanë biseduar diçka konkrete rreth kërkesës së prokurorisë për sekuestrim, në këtë çështje thekson se kolegu A., nuk ia ka përmendur, as kërkuar që kërkesa e prokurorit për sekuestrim të refuzohet, sepse ai në fakt nuk ishte në dijeni për një kërkesë të tillë dhe nuk ishte në dijeni se e kishte pranuar, me shpjegim se kërkesa ishte dorëzuar në gjykatë më 14 tetor 2022, siç është cekur më lartë, objektin e gjykatës e ka lëshuar rreth orës 11:00, pasi ka shkuar në zyrë ditën e hënë e ka parë kërkesën e prokurorisë për sekuestrim në zyrën ku punon, pastaj i ka marrë veprimet procedural ligjore.

Lidhur me pretendimet e cekura më lart e duke vepruar sipas kërkesës së kryetarit të Gjykatës Supreme si autoritet kompetent, lidhur me dhënien e deklaratës, gjyqtari A.M., në deklaratën e tij thekson:

Nuk qëndrojnë pretendimet se më datë 17.10.2022, në intervalin kohor prej orës 08:00-09:00, në restaurant "H.P." në Ferizaj, janë takuar me gjyqtarin I.I., rrjedhimisht nuk ka mund të zhvillohet biseda që pretendon prokurori i shtetit se është bërë mes tyre. Për më tepër, datën dhe intervalin kohor kur pretendohet se janë takuar me gjyqtarin në fjalë thekson se ka qenë në vendin e punës zyrën nr. 404, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ky fakt mund të vërtetohet përmes disa burimeve dhe atë: Fillimisht me këtë datë diku prej orës 7:20-08:00, ka drejtuar automjetin zyrtar 4Z-..., prej Ferizajt në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë, i cili veprim mund të konfirmohet përmes fletudhëtimit të plotësuar nga ana e tij ku theksohet data e udhëtimit, numri i ID, numri i pasagjerëve, destinacioni dhe nënshkrimi i drejtuesit të automjetit, si provë propozon fotokopjen e fletudhëtimit, kurse udhëtimi dhe paraqitja në vendin e punës mund të konfirmohet edhe nga ana e bashkëudhëtarëve në automjetin zyrtar 4Z-..., prej Ferizajt në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë, përkatësisht gjyqtarët R.N., dhe F.R.. Paraqitja në zyrë është bërë afërsisht pas orës 08:00, dhe puna e bërë në zyrën e tij dhe zyrat e kolegëve të tjerë me qëllim të votimit të lëndëve në kolegje mund të vërtetohet edhe përmes prezencës në votimin e dy lëndëve në kolegje penal, dhe atë votimi i lëndës së paraburgimit PN.II.nr.13/2022, me anëtarët e kolegjit gjyqtarët: V.D., R.R., si dhe bashkëpunëtoren profesionale, Q.B., dhe lëndën tjetër për mbrojtjen e ligjshmërisë PML.nr.393/2022, me anëtarët e kolegjit gjyqtarët: V.D., A.Sh, me bashkëpunëtoren Q.B., si provë propozon; shikimin e shkresave të lëndëve të votuara. Andaj, edhe njëherë e ri konfirmon faktin e vërtetuar përmes provave të propozuara më lartë se pretendimi për takim me gjyqtarin I.I., me datë, interval kohor dhe vend më datën 17.10.2022, prej orës 08:00- 09:00, në restorantin "H.P." në Ferizaj, siç pretendohet në kërkesë për dhënien e deklaratës nuk qëndron, pra ky takim nuk ka ndodhur fare.

Në vijim të deklaramit ka paraqitur edhe disa fakte që konsideron se janë të rëndësishme për këtë çështje, dhe atë fillimisht faktin se për takimin për të cilin është deklaruar më lartë, më parë ka marrë informacion përmes e-mailit zyrtar A.... kontaktuar nga ana e gazetarit B. M. më datë 11.11.2022, me kërkesë për intervistë, për të cilën i është përgjigjur më datën e

njëjtë dhe e ka njoftuar gazetarin se deri sa rasti të shqyrtohet nga institucioni përkatës nuk do të bëjë asnjë deklaratë për medime, tutje në këtë deklaram shton se me gjyqtarin I.I., ata njihen një kohë të gjatë rreth 15 vite, duke shërbyer në sistemin gjyqësor të Kosovë, kurse diku prej vitit 2010 – 2018, ka punuar si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj- Departamenti Krime të Rënda, deri sa ka kaluar në Gjykatën Supreme të Kosovës. Theksuar faktin se gjatë punës në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka punuar bashkërisht në trup gjykues dhe ka pasur bashkëpunim të shkëlqyer profesional, por edhe raporte të shkëlqyera miqësore, rrjedhimisht edhe takime të përditshme, kurse takime më të rralla me të njëjtin ka pasur edhe pas kalimit të tij në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Lidhur me takimin e fundit që ka pasur me gjyqtarin I.I., mund të jetë diku rreth një javë para datës 17.10.2022, dhe biseda është zhvilluar rreth çështjeve të përditshme dhe zakonshme, kurse fokusi i bisedës ka qenë për gjendjen shëndetësore të tij, meqë kohëve të fundit ka pasur probleme shëndetësore. Më pas thekson se në rastin konkret është i rëndësishëm fakti se bisedat e pretenduara përkitazi me sekuestrimin e vilave në Brezovicë nuk janë bërë, dhe për këtë çështje nuk është biseduar fare. Për më tepër, në kohën e takimit me gjyqtarin I., me sa mund të rikujtoj dinamikën e ngjarjeve të zhvilluara ende nuk ka pasur kërkesë për sekuestrim të vilave në rastin "Brezovica" dhe kjo rrjedhimisht as që ka mundur të jetë temë e bisedës me të.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, deklaratës së gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, I.I., deklaratës së gjyqtarit A.M., si subjekt i hetimit disiplinor, provave të ofruara nga gjyqtari; fletudhëtimit të plotësuar për automjetin zyrtar 4Z-...; vështrimin në shkresat e lëndës PN.II.nr.13/2022 dhe PML.nr.393/2022, si dhe emisioni "Betimi për Drejtësi" i emituar në KTV më datë 12.11.2022, konstaton si në vijim:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, R.M., përmes emailit dërguar Kryesuesit të KGJK-së, kishte dyshime se gjyqtari A.M., – subjekti i hetimeve disiplinore, ishte takuar me gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, I.I., dhe sipas tij, ku i njëjti i ka kërkuar ta refuzoj kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e përkohshëm të vilave, sepse nuk ka bazë juridike me arsyetim se ka qëllim të avancohet në pozitë të kryetarit të Gjykatës Supreme. Të njëjtat pretendime i ka potencuar edhe në emisionin "Betimi për Drejtësi". Për sqarim të kësaj situate meqenëse prokurori në fjalë nuk ka qenë prezent në takimin e pretenduar, si autoritet kompetent ashtu siç u cek më lart kam kërkuar të deklarohet gjyqtari I.I.. Nga deklarata e tij u vërtetua se është takuar me gjyqtarin A., por ky takim ka qenë më tepër takim kolegësh të vjetër dhe arsyeja e takimit nuk ka qenë për ndonjë rast në procedurë por interesimi rreth shëndetit të tij, si dhe biseda të përgjithshme. Edhe gjyqtari A., nuk mohon takimin me gjyqtarin I., përveç që konteston datën 17 tetor 2022, si ditë të takimit dhe për këtë ka ofrua provat e prezantuara më lart. Fakt qenësor lidhur me këtë takim u vërtetua fakti se, gjyqtari I.I. në deklaratën e tij, shprehimisht potencoi faktin se në takim nuk e ka ditur se ka kërkesë nga ana e prokurorit të çështjes për sekuestrim të përkohshëm të vilës së gjyqtarit A.M.. Pra sipas tij më datë 14.11.2022, rreth orës 11:00, për shkak terapisë mjekësore ka dal nga gjykata, dhe se nuk ka qenë në dijeni për ndonjë kërkesë për sekuestrim të përkohshëm, andaj, as që ka mundur të

zhvilloj bisedë me gjyqtarin A., pasi që nuk ka qenë në dijeni për kërkesën e prokurorit. Ligji për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve, përveç tjerash kërkon të vërtetohet baza e arsyeshme. Për autoritetin kompetent në rastin konkret mungon vërtetimi i bazës së arsyeshme për fillimin e hetimit disiplinor, pasi që gjyqtari i këtij rasti I.I., është personi që pretendohet nga pala ankuese-prokurori, se gjyqtari A., ka ndikuar në pavarësinë e tij në vendimmarrje që është kundër etikes profesionale. Këtë e mohon vet gjyqtari I.I., ndërsa pretendimet e palës ankuese nuk mund të vërtetohen me asnjë provë tjetër.

Nga një gjendje e tillë e fakteve, si autoritet kompetent konstatoj se pretendimet lidhur me shkeljet e bëra nga subjekti i hetimit gjyqtari A.M., nuk janë provuar, andaj, në mungesë të fakteve të provuara mbi bazën e të cilave do të mund të kualifikohej shkelja e pretenduar konstatoj se nuk ka vend për fillimin e hetimeve disiplinore, ashtu siç pretendon ankuesi.

Nga arsyet e cekura e në bazë të nenit 9 par. 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores së KGJK-së, nr.05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj

U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Gjyqtarit A.M.,
3. Arkivi i Gjykatës Supreme.